

URDHËR
Nr. 848, datë 3.7.2025

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7/2025 ‘PËR NJOHJEN E PERIUDHAVE TË PUNËSIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE, NË ISH-NDËRMARRJET SHTETËRORE, NË ISH-NDËRMARRJET BUJQËSORE DHE NË ISH-KOOPERATIVAT BUJQËSORE PËR EFEKT PENSIONI NË SISTEMIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE”

Në mbështetje të nenit 102 pika 4, të Kushtetutës, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 9, të ligjit nr. 7/2025, datë 30.1.2025, “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”, me propozim të Institutit të Sigurimeve Shoqërore,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për zbatimin e ligjit nr. 7/2025 ‘Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore’”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe është pjesë e përbërëse e tij.
 2. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
 3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja

RREGULLORE
PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 7/2025, “PËR NJOHJEN E PERIUDHAVE TË PUNËSIMIT NË INSTITUCIONET SHTETËRORE, NË ISH-NDËRMARRJET SHTETËRORE, NË ISH-NDËRMARRJET BUJQËSORE DHE NË ISH-KOOPERATIVAT BUJQËSORE PËR EFEKT PENSIONI NË SISTEMIN E SIGURIMEVE SHOQËRORE”

Neni 1

Qëllimi dhe objekti

1. Rregullorja “Për zbatimin e ligjit nr. 7/2025 ‘Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore’” (në vijim “rregullorja”), ka si qëllim përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit dhe të procedurave administrative të vlerësimit të kërkesave “Për caktim pensioni”, në të cilat deklarohen edhe periudha sigurimi objekt i këtij ligji.

2. Objekt i kësaj rregulloreje janë kërkesat “Për caktim pensioni”, në të cilat është kërkuar edhe njohja e periudhave të sigurimit objekt i ligjit nr. 7/2025 ‘Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore’.

3. Për një periudhë kalimtare, objekt i kësaj rregulloreje janë edhe rastet kur kërkuesit i është caktuar pension përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025 dhe në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji kërkesat për njohjen e periudhave të sigurimit, janë në shqyrtim administrativ në Komisionin Rajonal të Ankimit dhe në Komisionin Qendror të Ankimit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore ose në proces gjykimi në gjykatë.

Neni 2
Baza ligjore

1. Rregullorja mbështetet në legjislacionin si vijon:
- a) ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar;
 - b) ligjin nr. 7/2025, datë 30.1.2025 “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”;
 - c) vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 13.9.2017, “Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike”;
 - ç) vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.4.2022, “Për procedurat e ofrimit të shërbimeve *online* nga institucionet, dhe për metodologjinë e monitorimit dhe të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”.

Neni 3
Fusha e zbatimit

1. Rregullorja shtrin efektet e saj mbi të gjitha çështjet që rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 7, datë 30.1.2025 “Për njohjen e periudhave të punësimit në institucionet shtetërore, në ish-ndërmarrjet shtetërore, në ish-ndërmarrjet bujqësore dhe në ish-kooperativat bujqësore për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore”.
2. Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore vetëm për kërkesat për pension, në të cilat kërkohet edhe njohja e periudhave të sigurimit sipas ligjit nr. 7/2025.

Neni 4
Subjektet përfituese dhe periudhat e sigurimit

1. Subjekte të kësaj rregulloreje, në zbatim të nenit 2, të ligjit nr. 7/2025, janë personat të cilëve iu lind e drejta për caktimin e një pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore dhe kërkojnë të trajtohen edhe sipas neneve 3, 4 apo 5 të këtij ligji.
2. Njihet periudhë e përgjithshme sigurimi, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore:
- a) koha e punësimit në institucionet apo në ish-ndërmarrjet shtetërore;
 - i) nga mosha 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, deri më datë 1.10.1993, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
 - ii) nga data e përfundimit të shkollës së lartë deri më datë 1.10.1993;
 - b) koha e punësimit në ish-ndërmarrjet bujqësore, nga mosha 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, por jo më herët se data e krijimit të ish-ndërmarrjes bujqësore sipas vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të pikës 1, të nenit 9, të ligjit nr. 7/2025, deri më datë 17.10.1992, datë në të cilën ka hyrë në fuqi vendimi nr. 452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, “Për ristrukturimin e ndërmarrjeve bujqësore”;
 - c) koha e punësimit në ish-kooperativat bujqësore nga mosha 18 (tetëmbëdhjetë) vjeç, por jo më herët se viti i krijimit të kooperativës bujqësore, deri më datë 19.7.1991, datë në të cilën ka hyrë në fuqi ligji nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për tokën”.

Neni 5
Rrethi i kompetencave

Në kompetencë shqyrtimi sipas kësaj rregulloreje, janë praktikat e personave që:

- a) iu ka lindur e drejta për pension nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025 e në vazhdim;

b) deri në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025, nuk u është caktuar ende një pension pavarësisht datës së plotësimit të moshës për pension pleqërie apo të kriterëve ligjorë për pensionet e tjera të administruara nga sigurimet shoqërore;

c) iu është refuzuar kërkesa për caktim pensioni për shkak të mos plotësimit të kriterit ligjor të periudhës minimale të sigurimit, pavarësisht nëse vendimi i Degës së Përfitimeve është apo nuk është shqyrtuar në hallkat e ankimit administrativ sipas nenit 86, të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar;

ç) iu është caktuar pensioni, por përfituesit i është dërguar vendim/shkresë zyrtare për mos konfirmimin e periudhave të punësimit të deklaruar, objekt i ligjit nr. 7/2025, ndaj të cilit ai (përfituesi), ka bërë ankim dhe praktika në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji është në shqyrtim në KRA, KQA ose kur kërkesa për rishqyrtim bëhet brenda vitit nga data e plotësimit të moshës për pension pleqërie apo të kriterëve ligjorë për pensionet e tjera të administruara nga sigurimet shoqërore;

d) janë në proces gjyqësor për njohjen/vërtetimin e periudhave të punësimit objekt i ligjit nr. 7/2025.

Neni 6

Kërkesa dhe procedurat e administrimit

1. Kërkesa për tu trajtuar sipas ligjit nr. 7/2025, realizohet nëpërmjet kërkesës për caktim pensioni në *e-Albania*, në shërbimet “*Aplikim për pension...*”, duke zgjedhur në formularin që shfaqet me përdorimin e këtij shërbimi elementin përkatës për t’u trajtuar me ligjin nr. 7/2025.

2. Administrimi, shqyrtimi, vlerësimi dhe vendimmarrja, lidhur me kërkesën e paraqitur sipas pikës 1, të këtij neni, realizohet sipas të njëjtave rregulla dhe procedura që parashikohen për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve në sistemin e sigurimeve shoqërore.

Neni 7

Kriteret dhe dokumentacioni

1. Njohja për efekt pensioni e periudhës së sigurimit sipas ligjit nr. 7/2025, bëhet me kusht që kërkuesi:

a) gjatë periudhës objekt i ligjit nr. 7/2025, të mos ketë qenë duke vuajtur dënimin me heqje lirie për arsye jo politike;

b) të ketë qenë me vendbanim në qytet, sipas deklaratës së kërkuarit për njohjen e periudhave të sigurimit në institucione shtetërore apo në ish-ndërmarrjet shtetërore;

c) të ketë qenë me banim në territorin ku ushtronte aktivitetin ndërmarrja bujqësore, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave në zbatim të pikës 1, të nenit 9, ligjit nr. 7/2025, sipas deklaratës së kërkuarit për njohjen e periudhave të sigurimit në ish-ndërmarrje bujqësore;

d) të ketë qenë me vendbanim në fshat, sipas deklaratës së kërkuarit për njohjen e periudhave të sigurimit në kooperativë bujqësore.

2. Vërtetimi i vendbanimit për efekt të njohjes së periudhës së punësimit sipas ligjit nr. 7/2025, bëhet më anë të certifikatës familjare të periudhës së kërkuar dhe objekt i këtij ligji, e cila administrohet nëpërmjet sistemeve elektronike nga punonjësit përgjegjës të strukturave të Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Për rastet e periudhave të kërkuara në institucione shtetërore, siç parashikohet në shkronjën “b”, të pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 7/2025, kërkuesi paraqet kopje të njësuar me origjinalin të diplomës së shkollës së lartë.

4. Punonjësit përgjegjës të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për efekt të njohjes së periudhave të sigurimit sipas ligjit nr. 7/2025, në zbatim të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 3; të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 4 dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 5, të këtij ligji, administrojnë edhe vërtetimin e gjendjes gjyqësore që vërteton se kërkuesi nuk ka qenë i dënuar për arsye jo politike në periudhën e kërkuar objekt i këtij ligji.

Neni 8

Njohja e periudhave të sigurimit

1. Specialisti përpunues, për trajtimin e kërkesës për pension vlerëson periudhat e punësimit të kërkuara dhe për efekt të dokumentimit të tyre, krahas dokumentacionit të parashikuar për t'u administruar për caktimin e pensionit të kërkuar, administron edhe dokumentacionin e parashikuar në nenin 7, të kësaj rregulloreje.

2. Periudhat e sigurimit, që kërkojnë për t'u njohur sipas ligjit nr. 7/2025, njihen dhe llogariten për efekt pensioni, sipas neneve 3, 4 dhe 5 të këtij ligji, si periudhë e plotë, pavarësisht deklaratës së përfituesit dhe përmbajtjes së dokumentacionit të vjetërsisë në punë.

3. Periudhat e tjera të sigurimit, të shtrira në harkun kohor para moshës 18 vjeç të kërkuarit, apo pas datave të mbarimit të periudhave të parashikuara në nenet 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 7/2025, llogariten dhe njihen për efekt pensioni, kur ato konfirmohen dhe vërtetohen në dokumentacionin zyrtar të vjetërsisë në punë, sipas legjislacionit në fuqi.

4. Kërkesat për pensione, në të cilat janë deklaruar periudha punësimi në institucione, ish-ndërmarrje shtetërore, ish-ndërmarrje bujqësore dhe ish-kooperativa bujqësore, por nuk njihen sipas ligjit nr. 7/2025 ose në detyra/funksione specifike, llogaritja e të cilave ka efekte më të favorshme në masën e pensionit se periudhat që njihen sipas neneve 3, 4 dhe 5, të këtij ligji, me kërkesën e përfituesit, ndjekin procedurën sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 9

Të drejtat e fituara

1. Të drejtat e fituara nga ligji nr. 7/2025, janë objekt rivlerësimi vetëm për vendimmarrje me efekte më të favorshme në masën e pensionit.

2. Periudhat e punësimit të njohura me ligje të veçanta, për efekt pensioni në sistemin e sigurimeve shoqërore, vazhdojnë të njihen të tilla dhe nuk janë objekt trajtimi sipas ligjit nr. 7/2025.

Neni 10

Dispozitë Kalimtare

1. Për pensione, kur kërkuarit i është caktuar pension nga sigurimet shoqërore përpara datës së hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025 dhe në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, janë në shqyrtim administrativ në Komisionin Rajonal të Ankimit dhe në Komisionin Qendror të Ankimit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore:

a) Komisioni Rajonal i Ankimit në DRSSH apo Komisioni Qendror i Ankimit në ISSH, për rastet që në bazë të ankimit të ushtruar konstaton se periudhat e deklaruara, por të panjohura për efekt pensioni, janë objekt i neneve 3, 4 apo 5, të ligjit nr. 7/2025, pezullon procedurën dhe delegon dosjen për shqyrtim e vlerësim të mëtejshëm në Degën e Përfitimeve në DRSSH/DSSH.

b) DRSSH/DSSH, informon kërkuarin, në llogarinë e tij në *e-Albania* dhe nëpërmjet shërbimit postar, për pezullimin dhe shkaqet e pezullimit të procedurës nga KRA-ja apo KQA-ja.

c) Dega e Përfitimeve, shqyrton rastin sipas ligjit nr. 7/2025 dhe sipas kësaj rregulloreje, si dhe merr vendim përfundimtar lidhur me periudhën e kërkuar, por të pa njohur, objekt i ligjit:

i) Në rast të një vendimmarrje negative, Dega e Përfitimeve, njofton kërkuarin për vendimin në llogarinë e tij në *e-Albania* dhe dosja rikthehet në komisionin që ka pezulluar procedurën, me qëllim shqyrtimin e mëtejshëm administrativ;

ii) Në rastet e tjera, ndryshe nga sa parashikohet në pikën “i”, të shkronjës “c”, të këtij neni, Dega e Përfitimeve njofton kërkuarin në llogarinë e tij në *e-Albania*, për vendimin e marrë dhe për të drejtën e ankimit sipas nenit 86, të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar.

2. Për pensione, kur kërkuarit i është caktuar pension nga sigurimet shoqërore përpara datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji dhe paraqet kërkesë për rishqyrtim për njohjen e periudhave të panjohura dhe objekt i ligjit nr. 7/2025, brenda një viti nga plotësimi i moshës për pension pleqërie apo të kritereve ligjore për pensionet e tjera të administruara nga sigurimet shoqërore, DRSSH/DSSH shqyrton rastin sipas ligjit nr. 7/2025 dhe sipas kësaj rregulloreje, si dhe merr vendim përfundimtar lidhur me periudhën e kërkuar, por të pa njohur, objekt i ligjit.

3. Për çështjet në proces gjyqësor, me objekt gjykimi njohjen/vërtetimin e periudhave të sigurimit që njihen sipas neneve 3, 4 dhe 5, të ligjit nr. 7/2025, juristi/përfaqësuesi i autorizuar pranë DRSSH-së apo DSSH-së:

a) informon gjykatën për zgjidhjen administrative të rastit për aq sa është e përcaktuar në ligjin nr. 7/2025, në rast se gjykimi është në proces;

b) harton relacion për mos ankim/rekursim të vendimeve të gjykatave që kanë njohur periudha sigurimi objekt i ligjit nr. 7/2025 dhe janë ende brenda afateve për ankim/rekurs në shkallën më të lartë të gjykimit;

c) harton kërkesën për tërheqjen e ankimit në Gjykatën e Apelit apo të rekursit në Gjykatën e Lartë, në rast se objekt gjykimi janë periudhat e sigurimit të njohura sipas 3, 4 dhe 5, i ligjit nr. 7/2025;

ç) nëse periudha e sigurimit objekt gjykimi i tejkalon periudhat e njohura sipas dispozitave përkatëse të ligjit nr. 7/2025, juristi/përfaqësuesi i autorizuar bën tërheqje të pjesshme të ankimit/rekursit ose relacion për mos ankim të pjesshëm vetëm për ato periudha sigurimi të cilat janë objekt i ligjit nr. 7/2025;

d) vendimi i gjykatës, së bashku me relacionin për mos ankim ose kërkesën për tërheqje ankimi të firmosur nga drejtori i DRSSH/DSSH, dërgohet për ekzekutim në Degën e Përfitimeve, e cila e ekzekuton atë sipas relacionit për mos ankim apo kërkesës për tërheqje ankimi pa pritur që vendimi të marrë formës së prerë.

Neni 11

E drejta e zgjedhjes për përfituesit e pensionit social

1. Përfituesi i pensionit social, sipas nenit 5/1, të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, ka të drejtë të kërkojë të trajtohet sipas ligjit nr. 7/2025, për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë.

2. Llogaritja e pensionit të pleqërisë, për rastet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet në bazë të ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar, sipas kritereve ligjore në fuqi në datën e plotësimit të moshës për pension pleqërie.

Neni 12

Efektet financiare të përfitimeve të caktuara/rishqyrtuara me periudha të njohura në zbatim të ligjit nr. 7/2025

1. E drejta e pagesës për pensionet e caktuara mbi bazën e periudhave të sigurimit sipas ligjit nr. 7/2025 apo për pensionet e rishqyrtuara sipas nenit 8, të këtij ligji dhe të nenit 10, të kësaj rregulloreje, do të jetë:

a) Për pensionet e pacaktuara, të cilat në datën e hyrjes në fuqi kanë qenë në shqyrtim në Komisionin Rajonal të Ankimit, Komisionin Qendror të Ankimit ose në gjykatën e shkallës së parë për të cilat nuk ka ende një vendim:

i. nga data e plotësimit të moshës për pension pleqërie apo kritereve ligjore për pensionet e tjera të administruara nga sigurimet shoqërore, nëse kërkesa për caktim pensioni, objekt shqyrtimi ne procedurë administrative ose gjyqësore, është bërë brenda 1 viti nga kjo datë;

ii. nga data e kërkesës, nëse kërkesa për caktim pensioni, objekt shqyrtimi ne procedurë administrative ose gjyqësore, është bërë pas një viti nga data e lindjes së së drejtës;

b) Për pensionet e rishqyrtuara, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të nenit 10, të kësaj rregulloreje dhe të shkronjës “a”, të pikës 3, të këtij neni, për të cilat gjykata nuk është shprehur ende me një vendim, efektet financiare shtrihen deri në tre vjet sipas dispozitave ligjore në fuqi;

c) Për pensionet, që në datën e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025, kanë qenë në proces gjyqësor, për të cilat ka një vendim gjykate:

i. nga data e lindjes së të drejtës, nëse kërkesa për caktim pensioni është bërë brenda 1 viti nga kjo datë;

ii. nga data e kërkesës, nëse kërkesa për caktim pensioni është bërë pas një viti nga data e lindjes së të drejtës;

- ç) Për pensionet e pacaktuara, me datë lindje të së drejtës para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025, për të cilat paraqitet kërkesë për herë të parë për caktim pensioni pas hyrjes në fuqi këtij ligji:
- i. nga data e lindjes së të drejtës, nëse kjo kërkesë paraqitet brenda një viti nga kjo date;
 - ii. nga data e kërkesës, nëse kjo kërkesë është paraqitur pas një viti nga data e lindjes së të drejtës;
- d) Për pensionet e pacaktuara, për shkak të mos plotësimit të periudhës minimale të sigurimit, që paraqitet kërkesë për caktim pensioni pas hyrjes në fuqi të ligji nr. 7/2025 dhe kur ky kriter (periudha minimale e sigurimit), plotësohet si rezultat i zbatimit të këtij ligji:
- i. nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7/2025, kur ka kaluar një vit nga data e plotësimit të moshës pension pleqërie apo kritereve ligjore për pensionet e tjera të administruara nga sigurimet shoqërore dhe kërkesa është paraqitur brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji;
 - ii. nga data e kërkesës, kur ka kaluar një vit nga data e plotësimit të moshës për pension pleqërie apo kritereve ligjore për pensionet e tjera të administruara nga sigurimet shoqërore dhe kërkesa është paraqitur pas një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji;
- dh) Për pensionet, me datë lindje të së drejtës para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025, për të cilat kërkesa për rishqyrtim pensioni paraqitet pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, efektet financiare janë nga data e lindjes së të drejtës, nëse kjo kërkesë paraqitet brenda një viti nga kjo datë.
2. Pensionet e caktuara, sipas nenit 11 të kësaj rregulloreje:
- i. nga data e hyrjes në fuqi e ligjit nr. 7/2025, nëse kërkesa për caktim pensioni pleqërie bëhet brenda një viti, nga kjo datë;
 - ii. nga data e kërkesës, nëse kërkesa për pension pleqërie paraqitet pas një viti nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7/2025.

Neni 13

Dispozitë e fundit

1. Zbatimi i kësaj rregulloreje është objekt kontrolli, sipas programeve për vlerësimin e ligjshmërisë së caktimit të pensioneve nga struktura përgjegjëse e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.
2. Moszbatimi i parashikimeve në rregullore ngarkon me përgjegjësi punonjësit përgjegjës, sipas parashikimeve të rregullores në fuqi “Për personelin e ISSH-së”.
3. Rregullorja hyj në fuqi menjëherë.